

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
 ODLUKA JE PRAVNOGNAZNA  
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
 FERIZAJ I UROSEVAC

NË EMËR TË POPULLIT

30. 05 2018

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm –**

**Divizioni Penal**, në përbërje nga gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, me zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDACTED] për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par. 1 nën par. 1.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 1214-2/16 të datës 06.10.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 26.03.2018 në prani të prokurorit të shtetit Sebahate Sinani, të dëmtuarit [REDACTED] dhe të akuzuarit [REDACTED], mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 11.04.2018, përpiloi me shkrim këtë:

#### A K T G J Y K I M

**I akuzuari:** [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna [REDACTED], i lindur me [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], me nr. personal [REDACTED], ka të kryer shkollën e mesme, me profesion moler, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në paraburgim prej dt. 25.07.2016 deri më datë 24.08.2016.

#### ESHTË FAJTOR

Se më datë 23.07.2016, rreth orës 19:40 në Ferizaj, në rrugën “Dëshmorët e Kombit”, pas një mosmarrëveshje lidhur me problemet të më hershme me të dëmtuarin [REDACTED] e ka sulmuar fizikisht, në atë mënyrë që është takuar në qendër të qytetit dhe me të takuar aty për aty e godet me grusht në pjesën e fytyrës, saktësisht në hundë ku si pasojë e goditjes i dëmtuari pëson lëndime të rënda trupore – ndrydhje dhe thyerje në hundë,-

me të cilën ka kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par. 1 nën par. 1.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata ne bazë të neneve 4,7, 17, 21, 41, 43, 45, 46, 47, dhe 73 të KPRK-së, si dhe të nenit 365 te KPPRK-së,

### E GJYKON

Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim konform nenit 47 të KPRK-së, i zëvendësohet me dënim gjobe në shumë prej 1,000.00 € (njëmijë) euro, nga i cili dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, nga data 25.07.2016 e deri me datë 24.08.2016, pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Dënimin e shqiptuar me gjobë do ta paguaj në afat prej 30 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë. Në rast se dënimi i zëvendësuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet në mënyrat tjera të parapara në nenin 46 te KPRK-se, dënimi do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 euro do të vuaj një ditë burgimi.

I dëmtuari [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 30 € /tridhjetë/, për shpenzimet e procedurës penale të paguaj shumën prej 20 € /njëzet/ si dhe në emër të fondit të viktimave të paguaj shumën prej 30 € /tridhjetë/, në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

### A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II nr. 1214-2/16 të datës 06.10.2016, ka akuzuar [REDAKTUAR] të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par. 1 nën par. 1.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë 22.06.2017, i akuzuari ka pranuar fajësinë, mirëpo prokuroja e shtetit Sebahate Sinani e ka kundërshtuar pranimin e fajësisë

nga ana e të pandehurit me qenë se ka kërkuar që në seancën e radhës të ftohet edhe i dëmtuari [REDAKTUAR], për shkak të vërtetimit lidhur me natyrën e lëndimeve të pësuar në ditën kritike. Gjykata pas kundërshtimit të prokurores së shtetit për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, mori aktvendim që të mos behet pranimi i fajësisë nga i akuzuari në këtë fazë të procedurës dhe në seancën e radhës të ftohet dhe të dëgjohet i dëmtuari lidhur me lëndimet e marra. Me datën 26.03.2018 Gjykata caktoi shqyrtimin gjyqësor, në të cilin shqyrtim prokurorja e shtetit bazuar në ekspertizën mjeko-ligjore të dt. 19.12.2017, për të cilën Gjykata kishte lëshuar urdhëresë për ekspertizë, me qëllim të vërtetimit të saktë të lëndimeve të pësuar nga i dëmtuari, prokurorja e shtetit ne seancën e shqyrtimit gjyqësor ka bërë ndryshimin e dispozitivit të aktakuzës PP/nr.1214-/16 ndaj të pandehurit [REDAKTUAR] dhe atë sa i përket rreshtit të parafundit dhe të fundit të dispozitivit, ku në vend se të jetë “i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore”, e ka ndryshuar në “i dëmtuari si pasoj e goditjeve pësoj lëndime të rënda trupore duke u bazuar në ekspertizën mjeko-ligjore me nr. FE-996/17 të dt. 19.12.2017, si dhe bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit ka ndryshuar kualifikimin juridik, ku në vend të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 të KPRK-së, e ka ndryshuar në “me të cilën kreu veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 nen par. 1.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 26.03.2018, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit të ndryshuar në dispozitivin e saj, i akuzuari [REDAKTUAR] e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza në të gjitha pikat e saj.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 326 par. 1 lidhur nenin 248 të KPPRK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit gjatë procedurës hetimore dhe në shqyrtimin gjyqësor, mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko-ligjor i dt. 19.12.2017, raporti i oficerit, foto dokumentacioni, si dhe shkresat tjera te lendes si dhe provat te tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të mbledhura në hetuesi.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjykata konform nenit 248 paragrafit të KPPRK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye gjykata ka vazhduar në fjalën përfundimtare dhe me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par. 1 nën par. 1.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, sjelljen korrekte gjatë tërë procedurës, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit siç parashihet në dispozitat e nenit 41 të KPRK-së. Andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Konform nen. 450 dhe 451 të KPPK-së, Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30 € /tridhjetë/ si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej 20 /njëzet/€ në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform neni 39 par. 3 pika 3.1, nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit


Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**P.nr.988/16, me datë 11.04.2018**

**Zyrtare Ligjore,**  
Ganimete Avdiu

**Gjyqtarja,**  
Hakile ILAZI



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.